

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Investimi publik me objekt: “Lidhja e Currilave me Rrugën “A. Goga”.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhja e sugjerimeve të komunitetit lidhur me investimin publik me objekt: “Lidhja e Currilave me Rrugën “A. Goga”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **online në faqen web të bashkisë Durrës për periudhën 4 Shkurt – 9 Shkurt 2026.**

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 9 Shkurt 2026, në adresën e emailit:

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës
- Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Online.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik “Investimi publik me objekt: “Lidhja e Currilave me Rrugën “A. Goga”, synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me përmirësimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe garantimin e aksesit normal dhe të sigurt për banorët e zones si dhe vlerësimin paraprak të objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat.
Përshkrimi i çështjes.	Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, bashkia ushtron dhe kompetenca që ka të bëjë me infrastrukturën dhe shërbimet publike, ku neni 23 i ligjit “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, përcakton se: “ ... Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: “....4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore...”. Duke e konsideruar si funksion të vetin, nga ana e bashkisë është projektuar, financuar dhe lidhur kontratë pune me të tretët për investimin me objekt: “Lidhja e Currilave me Rrugën “A. Goga”. Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore në fuqi, Bashkia Durrës ka për detyrë dhe përgjegjësi

	ligjore të ndërtojë, rehabilitojë dhe mirëmbajë infrastrukturën rrugore në territorin e saj administrativ, me synim përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Projekti “Lidhja e Currilave me Rrugën “A. Goga” është pjesë e një programi zhvillimor strategjik për qytetin e Durrësit, me ndikim të drejtpërdrejtë në: - rritjen e sigurisë rrugore; - lehtësimin e qarkullimit të mjeteve dhe uljen e trafikut urban; - përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve publike; - shtimin e aksesit në zonat turistike dhe ekonomike të qytetit; - rritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme në zonë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, BRENDA DATËS 9 Shkurt 2026. keshillidurres@gmail.com
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t’i gjeni në faqen Web të bashkisë, faja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisioneve të mësipërme të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në plan dhe në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	04.02.2026